



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK**

STUDIMET BACHELOR

**PLANPROGRAMI I LËNDËS
"E DREJTA ADMINISTRATIVE"**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Administrative
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2019/20
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	//
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Mirlinda Batalli Prof.Ass.Dr. Islam Pepaj
Detajet kontaktuese:	mirlinda.batalli@uni-pr.edu islam.pepaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>E drejta administrative si disiplinë shkencore përfshinë dhe analizon tërësinë e normave juridike me karakter administrativ, përmes së cilave rregullohet mënyra e funksionimit të administratës publike.</p> <p>Theksi kryesor i kësaj lëndë është analizimi i elementeve dhe instituteve të më poshtme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Normat juridike administrative; - Marrëdhëniet juridike administrative; - Akti administrativ; - Veprimtaria administrative; - Organizimi i administratës; - Organet e administratës; - Parimet e organizimit dhe të punës së organeve të administratës; - Shërbimet publike; - Autorizimet publike; - Format e kontrollit të veprimtarisë administrative; - Përgjegjësia politike e administratës; <p>Vëmendje e posaçme do ti kushtohet edhe procesit të reformimit të administratës e veçanërisht kompjuterizimit të saj si një proces më fundamental. Ky studim do të përfshijë edhe aspekte krahasimore për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim duke përfshirë edhe administratën publike të Kosovës.</p>

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i studimit të kësaj lëndë është përqendruar në qasjen teorike dhe praktike të njohjes dhe transformimit të marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi dhe të atyre juridike administrative në veçanti. Kjo qasje vë theks të veçantë në institutet më të rëndësishme që studiohen në shkencat administrative. Në zbatimin, ruajtjen dhe forcimin e ligjshmërisë rol të veçantë luajnë organet e administratës dhe organet e specializuara për ushtrimin e kontrollit. Zbatimi i ligjshmërisë nga ana e organeve të administratës kërkon edhe njohjen e garancive që ekzistojnë në vetë sistemin e këtyre organeve ose që janë ndërtuar për sigurimin e zbatimit të ligjit. Studimi përqëndrohet veçanarisht edhe në kuptimin e aktit administrativ. Akti administrativ është një nga format, mund të themi më kryesorja, në veprimtarinë ekzekutive dhe vendimmarrëse të administratës publike. E gjithë veprimtaria ekzekutive e çdo organi administrativ publik konkretizohet përfundimisht në momentin e nxjerrjes së aktit, sepse është akti administrativ, ai që krijon marrëdhënie të reja juridike për subjektet që iu drejtohet, që i ndryshon këto marrëdhënie të krijuara më parë, duke i përsosur më shumë, ose edhe i shuan. Akti administrativ duhet konceptuar si një deklaram apo shfaqje e një vullneti të qartë të pushtetit shtetëror në veprimtarinë e administratës publike, i kryer në përputhje të plotë me kushtetutën dhe me ligjet në tërësi, për të krijuar, për të ndryshuar apo për të shuar pasoja të caktuara juridike, i zbatuar nëpërmjet vullnetit të lirë të subjekteve që u drejtohet, ose me anë të fuqisë shtrënguese të shtetit.

Kontrulli për zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e administratës nga pikëpamja e kriterëve të subjekteve të së drejtës që merren me ushtrimin e tij dhe nga ajo e veçorive juridike që e karakterizojnë, paraqitet në këto forma: kontrulli i brendshëm dhe kontrulli i jashtëm. Me kontrull të brendshëm kuptojmë kontrullin që ushtron organi administrativ epror mbi organet vartëse lidhur me kryerjen e suksesshme të detyrave të tyre zyrtare. Kontrulli i brendshëm është pjesa kryesore në sferën e menaxhimit të institucioneve publike. Ky kontrull përfshin planet, metodat, dhe procedurat që zbatohen për realizimin e misionit, vizionit dhe

	objektivave të një organizate. Kontrolli i brendshëm duhet të ofrojë një siguri të arsyeshme lidhur me realizimin e objektivave në sferën e efektshmërisë dhe efikasitetit, sigurisë së raporteve të ndryshme financiare, pajtueshmërisë me ligjin dhe aktet nënligjore. Ndërkaq, kontrolli i jashtëm është kontrolli që organet e specializuara ushtrojnë mbi organet e tjera administrative dhe mbi zbatuesit e tjerë, me qëllim të sigurimit, të zbatimit të rregullt nga ana e atyre ligjeve e akteve nënligjore të organeve më të larta.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi/ligjeratave, studentët duhet të jenë të pajisur me njohuri bazike në fushën e te drejtës administrative në mënyrë që në të ardhmen të mund t'i zbërthejnë nocionet e kësaj fushe si në teori e po ashtu edhe në praktikë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	1/14	42
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/14	28
Punë praktike	1	1/14	14
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	3	1/14	42
Ushtrime në teren	1	1/1	1
Kollokfiime,seminare	3	3/3	9
Detyra të shtëpisë	2	1/10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1/15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1/1	3
Projektet,prezantimet ,etj	2	1/4	8
Totali			227
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda "E drejta administrative" do të vijohet përmes ligjëratave, seminareve, ushtrimeve duke mos i përjashtuar edhe format tjera të mundshme të studimit. Ligjërata do të paraqes prezantimin e rregullave themelore hyrëse dhe studime komperative të		

	<p>sistemeve të së drejtës lidhur me zhvillimin e së drejtës administrative. Ligjëratat do të jenë interaktive, për t'iu mundësuar studentëve një pjesëmarrje sa më aktive në temat që do të shtjellohen.</p> <p>Seminaret do të jenë një proces interaktiv i mësimet për studentët, duke u bazuar në studimin e pavarur të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen nga ana e mësimeve të lëndës.</p> <p>Studentëve u kërkohet që të shkruajnë së paku një punim seminarik që ka të bëjë me ndonjërin prej çështjeve apo temave të trajtuara gjatë ligjëratave. Pjesa e punës së shkruar do të llogaritet në vlerësimin final të studentit.</p> <p>Gjatë ushtrimeve, studentët do të kenë mundësi që përmes shembujve praktik të përvetësojnë me lehtësi mësimet e përciellura gjatë ligjërimit.</p>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Në vlerë duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i parë 25% ▪ Vlerësimi i dytë 25% ▪ Punimi seminarik, detyrat e shtëpisë ose angazhimet tjera 10% ▪ Vijimi i rregullt 10% ▪ Provimi final 30% <p>- Totali 100%</p>
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura bazë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - E Drejta Administrative – Administrata, Kontrolli i punës së Administratës dhe Përgjegjësia Politike e saj, Kompjuterizimi i Administratës, Prof. Esat Stavileci, Prof. Agur Sokoli, Prof. Mirlinda Batalli, Prishtinë, 2010. - E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative, Esat Stavileci, Mirlinda Batalli, Sokol Sadushi, Prishtinë, 2012 - E Drejta Administrative, Prof. Agur Sokoli, Prishtinë 2014.
<p>Literatura shtesë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - E Drejta Administrative – aspekte krahasuese, Bajram Pollozhani, Ermir Dobjani, Esat Stavileci, Lazim Salihu, Shkup, 2010.

	<ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në shkencat administrative, Prof. Esat Stavileci, Prishtinë, 1997. - Nociione dhe Parime të Administratës Publike, Prof. Esat Stavileci, Prishtinë 2005. - Kontrolli i punës së administratës dhe përgjegjësia e saj politike, Prof. Agur Sokoli, Prishtinë 2009 - E drejta administrative 2, Prof. Sokol Sadushi, Tiranë, 2000 - E drejta administrative 1, Prof. Ermir Dobjani, Tiranë, 2003 - E drejta administrative e RSH, libri i tretë i J.Çomo-s, 1983 - Judicial Review of Administrative Action, S.A.De Smith - Wade, H. R. W.: Administrative Law, New York, 1988. - J. C. Ricci: Droit administratif, Paris, 1996. - V. de Grutner: Allgemeins verwaltungsrecht, Berlin, 1988. - Gianini, M. S.: Istituzioni di diritto amministrativo, Milano, 1981. - Savremena administracija, Politicka encikopledia, Beograd, 1975. <p>Burimet e legjislacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kushtetuta e Republikës së Kosovës; - Ligji Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Nr. 06/L -113. - Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative i Kuvendit të Kosovës. Nr. 05/L - 031. - Ligji mbi Konfliktet Administrative i Republikës se Kosovës,Nr. 03/L-202 - Ligji për shërbimet e shoqërisë informative, Nr. 02L-23 - Akte të tjera juridike nga fusha e administratës
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet

<p>Java e parë:</p>	<p>Nocione të përgjithshme lidhur me të drejtën në përgjithësi dhe parimet nga shkencat administrative në veçanti.</p> <p>Zbërthimi i nocioneve themelore</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Administrata, Kontrolli i punës së Administratës dhe Përgjegjësia Politike e saj, Kompjuterizimi i Administratës</i>, Prof. Esat Stavileci, Prof. Agur Sokoli, Prof. Mirlinda Batalli, Prishtinë, 2010, fq. 7-23.</p>
<p>Java e dytë:</p>	<p>Shtirirja dhe sistemimi i njoftimeve themelore për lëndën.</p> <p>Kuptimi i përgjithshëm i së drejtës, shtetit, pushtetit, pushtetit shtetëror;</p> <p>Kuptimi i shtetësisë, organit shtetëror, veprimtarisë shtetërore dhe veprimtarisë administrative shtetërore;</p> <p>Akti juridik, Kushtetuta, Ligji, Akti Nënligjor, Akti Administrativ, Marrëdhëniet Juridike Administrative, Rendi Juridik, Sistemi Juridik, Institucioni Juridik, Dega Juridike, Subjekti Juridik etj.</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Administrata, Kontrolli i punës së Administratës dhe Përgjegjësia Politike e saj, Kompjuterizimi i Administratës</i>, Prof. Esat Stavileci, Prof. Agur Sokoli, Prof. Mirlinda Batalli, Prishtinë, 2010, fq. 41-63.</p>
<p>Java e tretë:</p>	<p>Karakterit i përgjithshëm dhe përmbajtja themelore e së Drejtës Administrative.</p> <p>E Drejta Administrative dhe shkenca e saj;</p> <p>Objekti i së drejtës administrative;</p> <p>Raporti i së drejtës administrative me shkencat tjera të së drejtës;</p> <p>Burimet e së drejtës administrative;</p> <p>Sistemi i së drejtës administrative.</p> <p>E Drejta Administrative dhe Shkenca mbi Administratën.</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Administrata, Kontrolli i punës së Administratës dhe Përgjegjësia Politike e saj, Kompjuterizimi i Administratës</i>, Prof. Esat Stavileci,</p>

	Prof. Agur Sokoli, Prof. Mirlinda Batalli, Prishtinë, 2010, fq. 65-93.
Java e katërt:	<p>Kontrolli i punës së Administratës</p> <p>Nocioni, qëllimi dhe llojët e kontrollit të punës së administratës.</p> <p>Subjektet, Objekti dhe autorizimet e kontrollit të punës së administratës;</p> <p>Llojët dhe format e kontrollit të administratës;</p> <p>Modelet e kontrollit administrativ të administratës;</p> <p>Kontrolli i jashtëm i administratës;</p> <p>Kontrolli parlamentar i administratës;</p> <p>Kontrolli gjyqësor i administratës;</p> <p>Kontrolli i administratës nga ana e prokurorisë dhe nga ombudsmani si formë e veçantë e kontrollit të punës së administratës.</p> <p>Përgjegjësia politike e administratës;</p> <p>Llojët e përgjegjësisë;</p> <p>Nocioni i përgjegjësisë politike, Llojët dhe natyra e sanksioneve mbi përgjegjësinë politike.</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Administrata, Kontrolli i punës së Administratës dhe Përgjegjësia Politike e saj, Kompjuterizimi i Administratës</i>, Prof. Esat Stavileci, Prof. Agur Sokoli, Prof. Mirlinda Batalli, Prishtinë, 2010, fq. 101-183.</p>
Java e pestë:	<p>Kompjuterizimi i Administratës</p> <p>Gjendja e administratës publike,</p> <p>Evoluimi i teknologjisë informative dhe procesi i reformimit të administratës publike;</p> <p>Vënia e administratës në shërbim të qytetarëve dhe dimensionet e administratës së kompjuterizuar;</p> <p>Efektet e Kompjuterizimit të administratës;</p>

	<p>Kompjuterizimi në fusha të veçanta të administratës publike;</p> <p>Kompjuterizimi i administratës së Universiteteve, Gjykatave, Shendetësisë, Sistemit Bankar etj;</p> <p>Trendet e Kompjuterizimit të Administratës Publike në vendet e zhvilluara;</p> <p>Përsosja e punës në administratën publike të vendeve në tranzicion;</p> <p>Administrata Publike në Kosovë.</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Administrata, Kontrolli i punës së Administratës dhe Përgjegjësia Politike e saj, Kompjuterizimi i Administratës</i>, Prof. Esat Stavileci, Prof. Agur Sokoli, Prof. Mirlinda Batalli, Prishtinë, 2010, fq. 195-313.</p>
Java e gjashtë:	Parapërgatitje për vlerësimin e parë
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë <u>*(te drejtë për të iu nënshtruar kolloqfiumit të parë kanë vetëm studentët të cilët vijojnë ligjeratat mbi 60 %).</u>
Java e tetë:	<p>Organizimi i administratës</p> <p>Organet e administratës;</p> <p>Nocioni i përgjithshëm i organizatës;</p> <p>Nocioni i organizatës administrative;</p> <p>Llojët e organizatave administrative;</p> <p>Organet e administratës;</p> <p>Klasifikimi i organeve të administratës shtetërore;</p> <p>Parimet e organizimit të administratës shtetërore;</p> <p>Shërbimet publike dhe institucionet për ushtrimin e tyre;</p> <p>Nocioni i shërbimit publik; klasifikimi i shërbimeve publike; autorizimet publike</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative</i>, Esat Stavileci, Mirlinda Batalli, Sokol Sadushi, Prishtinë, 2012, fq. 11-30.</p>

<p>Java e nëntë:</p>	<p>Organizimi i administratës shtetërore në vendet e ndryshme me rregullim të ndryshëm shoqëror (një vështrim krahasues)</p> <p>Organizimi i administratës shtetërore në Francë, Gjermani, SHBA, Bullgari, Greqi, Hungari, Itali, Rumani, Slloveni, Kroaci dhe Shqipëri.</p> <p>Administrata shtetërore në Kosovë;</p> <p>Organizimi i administratës në Kosovë nga viti 1999 nën Administrimin e UNMIK-ut dhe pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>Institucionet dhe organet e administratës shtetërore në Kosovë; Organet e larta, qendrore dhe lokale të administratës shtetërore në Kosovë;</p> <p>Organizimi i organeve të administratës shtetërore në Kosovë;</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative</i>, Esat Stavileci, Mirlinda Batalli, Sokol Sadushi, Prishtinë, 2012, fq. 32-94.</p>
<p>Java e dhjetë:</p>	<p>Veprimtaria Administrative</p> <p>Veprimtaria e organeve të administratës shtetërore;</p> <p>Funksionet themelore të shtetit;</p> <p>Përkufizimi i veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore;</p> <p>Parimet e punës së organeve të administratës;</p> <p>Parimi i Ligjshmerisë, mëvetësisë, efikasitetit, dhe parimi i punës së hapur të administratës</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative</i>, Esat Stavileci, Mirlinda Batalli, Sokol Sadushi, Prishtinë, 2012, fq. 97-106.</p>
<p>Java e njëmbëdhjetë:</p>	<p>Marrëdhëniet juridike administrative</p> <p>Llojet e marrëdhënieve juridike administrative;</p> <p>Normat juridike administrative;</p>

	<p>Marrëdhëniet ndërmjet organeve të administratës dhe marrëdhëniet e saj me organet e tjera të pushtetit;</p> <p>Klasifikimi i veprimtarisë së organeve të administratës;</p> <p>Marrëdhëniet ndërmjet vet organeve të administratës;</p> <p>Marrëdhëniet e organeve të administratës me organet e tjera të pushtetit shtetëror;</p> <p>Marrëdhëniet e organeve të administratës shtetërore me organet ligjvënëse;</p> <p>Marrëdhëniet e organeve të administratës shtetërore me organet ekzekutive;</p> <p>Marrëdhëniet e organeve të administratës me gjykatat.</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative</i>, Esat Stavileci, Mirlinda Batalli, Sokol Sadushi, Prishtinë, 2012, fq. 108-123.</p>
Java e dymbëdhjetë:	<p>Akti Administrativ</p> <p>Përkufizimi i aktit administrativ;</p> <p>Forma dhe përmbajtja e aktit administrativ;</p> <p>Veçoritë e aktit administrativ;</p> <p>Fuqia juridike e aktit administrativ;</p> <p>Vlefshmeria e aktit administrativ;</p> <p>Pavlefshmeria e aktit administrativ;</p> <p>Pushimi i fuqisë juridike të aktit administrativ.</p> <p>Literatura: <i>E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative</i>, Esat Stavileci, Mirlinda Batalli, Sokol Sadushi, Prishtinë, 2012, fq. 127-247.</p>
Java e trembëdhjetë:	Parapërgatitje për vlerësimin e dytë
Java e katërbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë *(te drejtë për të iu nënshtruar kollokfiomit te dytë kanë vetëm studentët të cilët e kanë kaluar kollokfiumin e parë).

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Respektimi i orarit në ligjëratë dhe ushtrime;
- Mos-lëshimi i sallës gjatë ligjëratave ose ushtrimeve;
- Ruajtja e integritetit akademik;
- Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor;
- Respektimi i rregullave gjatë provimit.